**VENDIM**

**Nr. 7, Datë 02/02/2016**

**PËR**

**MIRATIMIM E KOEFICENTIT TË KONKURSEVE TË PRANIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2016-2017, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të, Nenit 37 Senati Akademik, Nenit 38 Funksionet e Senatit Akademik, Kreu VII, Organizimi i Studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë, Neni 74, Pranimi në ciklin e parë të studimeve, me propozim nga njësitë bazë dhe nga Dekanët e Fakulteteve të UART, në datën 02/02/2016, Senati Akademik i UART u mblodh dhe diskutoi mbi miratimin e koeficientit të konkurseve të pranimit për vitin akademik 2016-2017.

Dekanët e fakulteteve paraqitën propozimet e tyre dhe më pas Senati Akademik, pasi dëgjoi dhe diskutimet e anëtarëve të tij unanimisht:

**VENDOSI**

1. Në Universitetin e Arteve koeficienti i notës mesatare i viteve të shkollimit dhe gjithë provimeve të Maturës Shtetërore të shkollës së mesme të llogaritet në masën **30%**, dhe rezultatet e konkursit të pranimit në masën **70%**.
2. Rregulloret dhe kriteret e konkurseve për secilin program studimi të ofruar në UART, të paraqiten nga fakultet për miratim në Senatin Akademik në mbledhjen e tij më të afërt.
3. Ky vendim Ju dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Fakulteteve të UART si dhe shpallet në faqen zyrtare të UART

**Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.**

Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel/Fax: +355 42 225 488, www.uart.edu.al

**SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

| | |
|---|---|
| **Prof. Petrit MALAJ** | **Prof. Kastriot ÇAUSHI** |
| **Prof. Artan PEQINI** | **Prof. Dr. Zana SHUTERIQI/PRELA** |
| **Prof. Gazmend LEKA** | **Prof. Haig ZACHARIAN** |
| **Prof. Milto KUTALI** | **Prof. Gazmend GJOKA** |
| **Prof. Bujar SYKJA** | **Prof. Ilir MARTINI** |
| **Prof. Astrit SELITA** | **Prof. Sadik SPAHIJA** |
| **Miranda BAKIASI** | **Prof. Fatmir MIZIRI** |
| **Elia PLAKU/ADEMI** | **Ramazan GURRA** |
| **Enisa VRENOZAJ** | **Kristina AGO** |
| **Albjan VUKA** | |



Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel/Fax: +355 42 225 488, www.uart.edu.al